Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

78- 22

Visar BIBAJ – Exp. Shqyrtues	***Data e autorizimit të ekspertit 29.03.2022***	***Data e dorëzimit të raportit 05.04.2022***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 28.03.2022, OE **"Ejona"shpk - Pejë** , ka parashtruar ankesë me nr: **78/22,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pompa per largimin e ujit nga Miniera",** me nr. të prokurimit: **12998-22-558-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Trepça sha**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, , lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **14,000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE pretendon se AK – nuk ka repsektuar dispozitat e LPP-se
Nenir 28 dhe 70, te LPP-se,

DEKLARATA DETALE E ANKESES
Ankesen tone per Rishqyrtim AK as fare nuk e merr parasyshe dhe pothuajse ne asnjë pike nuk e shqyrton vetëm jep nje përgjigje tekstuale ne te cilën shihet qe as qe nuk merr mundimin me lexu kërkesën tone per Ri shqyrtim.

OE i shpallur fitues prezanton pompën VCP 19- 5/9 me karakteristika teknike per pikat e kërkuara dhe me vone nënvizon 2 diagrame te ndryshme. Njerin diagram e nënvizon pompën me tip VCPv dhe me poshtë e nënvizon VCP (e cila as per se afërmi nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit) ne te cilat kërkohet prurje 6.6 L/sec dhe H = 250 m . Ne katalogun qe ka prezantu shpjegohet se pompat VCP kane numër te rrotullimeve deri 1450 rr/min dhe ne njërin diagram tregon pikat e pompës VCPv dhe tregon pikat e pompës

dhe ne diagramin e dyte nënvizon pokat e pompës ku vërtet shihen qe Hmax = 50 m.

Nga te dhënat qe cekem me larte OE i shpallur fitues ne diagramin qe e ka rrethu pikat e pompës maximumi i jep 50 meter dhe i njëjti eshte e paqarte se si eshte shpall fitues
Ne diagramin e pare shihet qe pompa VCP per 6L/S ne asnjë menyre nuk ju përafrohet pikave te kërkuara te pompës H=250 meter. **.....**

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
1.OE duhet të ofroj çertifikatën për cilesi ISO standard nga prodhuesi.
2. Duhet të ofrohen katalog ose përshkrime të produkteve të ofruara.
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1.Çertifikata ISO 9001 2015 .
2. Në katalog pjese të katalogut të nënvizohen artikujt e ofruar nga ku shifen përputhshmëria me specifikimet teknike të kërkuara.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Trepca sha, shpërblen me kontrat, "B7 D Enginering SHPK – Prishtine, me vlere totale prej 12 331.00 €.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Trepça sha, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizim me vlere te mesme. Pretendimet ankimore kane te bëjnë kundër vendimit për dhënie te kontratës.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore (neni 113): Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues "Ejona" shpk, me teje si parashtruesi i ankese, konteston kapacitetin e pompave te prezantuara nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës dhe deklaron se te njëjtat nuk korrespondojnë me kërkesat e aplikuara ne dosje te tenderit dhe njoftimit për kontrate, përkatësisht specifikacionet teknike te detyrueshme te aneksit 1.

Parashtruesi i ankesës, te njëjtat pretendime i ka ngritur edhe ne kërkese për ri shqyrtim ku janë kontestuar karakteristikat teknike te pompave, është pretenduar se është ofertuar me variante te pompave dhe diagrame te ndryshme dhe kapaciteti i pompës se variantit te dyte nuk korrespondon me kërkesat e AK-se për lidhur me sasinë dhe fuqi te pompës.

- Autoriteti Kontraktues – Trepça sha, përmes shkresës se datës.18.03.2022, kthen përgjigje ndaj kërkesës për ri shqyrtim dhe potencohet se operatori ekonomik i propozuar për dhënie te kontratës ka ofruar pompa sipas kërkesës se AK –se dhe me këto karakteristika:
  Tipi VCP 19.5-9; H = 250 – 380m ; Q= deri 6.6l/s dhe P=55kw .

- Tek kërkesat e kualifikimit, përkatësisht kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar nga ofertuesit qe te prezantojnë, "*katalog pjese të katalogut të nënvizohen artikujt e ofruar nga ku shifen përputhshmëria me specifikimet teknike të kërkuara*", përderisa tek aneksi 1, i dosjes se tenderit janë kërkuar karakteristikat e pompave dhe operatori ekonomik i propozuar për dhënie te kontratës me oferte ka prezantuar katalogun dhe pas krahasimit rezulton qe karakteristikat e prezantuara korrespondojnë me ato te kërkuara nga AK- Trepça sha. Për me tepër i njëjti OE, ka prezantuar edhe deklaratën mbi specifikat teknike, rrjedhimisht pretendimet ankimore i kualifikojmë si te pa bazuara.

Se bashku me raport gjeni kopjet e shkresave:

Aneksi 1, deklarata e specifikacioneve te pajisjeve, pjese nga katalogu për pajisjet.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te refuzohet ne tërësi si e pa bazuar, dhe ti lejohet AK-se qe te procedoj tutje me procedur te prokurimit.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Trepca sha.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Ejona shpk - Peje.